



KUVENDI I KOMUNËS SË PEJES

I.Numër:463-01/36013, dt. 28 Maj 2024.

Në bazë të nenit 11 dhe 12 të Ligjit për Vetqeverisjen Lokale nr. 03/L-40 të datës 20 shkurt 2008 dhe në mbështetje të nenit 24, dhe nenit 25 të Ligjit nr. 06/L-092 mbi dhënjen në shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës Komunale, nenin 29 dhe nenit 31 të rregullores (QRK) Nr.09/2020 për përcaktimin e Procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës si dhe nenit 20 paragrafi 1 pika 1.4 të Statutit Nr.01/2020 të Komunës së Pejës, I. Numër: 01-016/01-413431.dt.30. shtator 2020, pasi shqyrtoj propozimin e Kryetarit të Komunës për Miratimin e Këmbimit e Pronës së paluajtshme Komunale me pronën e pronarit privat Avdyl Çetaj, me rekomandim të Komitetit për Politik dhe Financa, Kuvendi Komunal Pejë, në takimin e mbajtur me datë: 28 Maj 2024, merr këtë:

VENDIM

Nr. 15/2024

Për këmbimin e pronës së paluajtshme Komunale me pronën private të Avdyl Çetaj me qëllim të realizimit të shtegut të ecjes buzë Lumit “Lumbardhë” dhe ndërtimit të rrugës “Maja Zezë” sipas PZHK.

- I. **Miratohet** propozimi – i Kryetarit të Komunës për këmbimin e pronës së paluajtshme Komunale me qëllim të realizimit të interesit publik formimi i rrugës për në shtegun e ecjes buzë Lumit Lumbardhë dhe ndërtimit të rrugës “Maja Zezë” sipas PZHK.
- II. Ngastra kadastrale nr. 2810-0 në sipërfaqe prej 257 m² ZK Pejë do të merret me qëllim të realizimit të shtegut të ecjes buzë Lumit “Lumbardhë” dhe ngastra nr. 365-15 në sipërfaqe prej 543 m² ZK Carravër për ndërtimin e rrugës “Maja Zezë” pronë e pronarit Avdyl Çetaj do të këmbetet me ngastren kadastrale nr. 3440-14 në sipërfaqe prej 1417 m² ZK Pejë Pronë Komuna e Pejës.
- III. Pjesë përbërse e këtij Vendimi janë vlerësimi nga Ministria e Finacave, Punës dhe Transfereve-Departamenti i Tatimit në Pronë të aprovuara me datën 17 prill 2024.
 - Prona e Komunës ngastra 3440-14 në sipërfaqe prej 1417 m² ZK Pejë është vlerësuar 180.00 €/m² që i bie totali 255,060.00 €.
 - Prona private e Avdyl Çetaj ngastra 2810-0 në sipërfaqe prej 257 m² ZK Pejë është vlerësuar 450.00 €/m² që i bie totali 115,650.00 €, ndërsa ngastra 365-15 në sipërfaqe prej 543 m² ZK Carravër është vlerësuar 50.00 €/m² që i bie total 27,150.00 €.
 - Ashtu që Avdyl Çetaj obligohet Komunës se Pejë t’ia kompenzoj diferencën në shumën prej 112,260.00 €.
- IV. Kjo procedurë do të nënshtrohet vlerësimit të ligjëshmërisë nga Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal.
- V. Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset Kryetari i Komunës dhe Drejtoria për Çështje Pronësoro – Juridike.

- VI. Ky vendim hynë në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të Ministrisë përgjegjëse për vetëqeverisje lokale, si dhe 7 (shtatë) pas publikimit në ëeb faqen e Komunës së Pejës.

Vendimi ti dërgohet:
MAPL-së,
Kryetarit të Komunës,
DÇPJ,
Arkiv.

